




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor


**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 11.08.2025 DERI MË 15.08.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për miratimin e kërkesës për ndihmë momentale.	NRP-02-6399-2025
2.	Vendimi për dhënien e dekoratës për humanizëm "Dr. Ali Sokoli".	NRP-02-6408-2025
3.	Vendim për pagesën e qirasë për akomodim për të riatdhesuar	NRP-02-6409-2025
4.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme.	NRP-02-6410-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së Shqipe Haxhimurati me Nr.Prot. 2435 të datës 23.7.2025, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa e znj. [redacted] nga Rahoveci, për strehim të përkohshëm emergjent si rast në nevojë sociale, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht prej datës 11.8.2025 deri më datë 11.2.2026, te familja strehuese [redacted] nga Brestoci, në Rr. "Xhelal Hajda", në Rahovec.
2. Pagesa në emër të qirasë mujore do të jetë në shumën prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.
3. **Autorizohet** drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit, që të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë.
4. Përfitues sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi është znj. [redacted] së bashku me fëmijët [redacted] dhe [redacted].
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit, ka pranuar kërkesë nga znj. [redacted] për ndihmë për strehim, pasi nuk ka shtëpi ku të jetojë, pasi nga të ardhurat e ndihmës sociale nuk mund të ndërtojë shtëpi.

DShPS-ja ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka vizituar familjen në nevojë, me ç'rast ka konstatuar që kjo familje është duke jetuar përkohësisht në një shtëpi me qira dhe në kushte të vështira ekonomike.

Andaj, duke marrë parasysh nevojën për ndihmë të familjes në nevojë të znj. [redacted] e cila është duke jetuar në kushte të vështira ekonomike dhe që e njëjta e ka të pamundur mbulimin e shpenzimeve për jetesë dhe pagesën e qirasë, është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Znj. [redacted]
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”), dispozitave të Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 të datës 31.5.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017 dhe rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e dekoratës për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”

1. Me këtë vendim, dekorata për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”, i jepet Prof. dr. Samedin Haxhijaha, pas vdekjes, për kontributin shumëvjeçar të dhënë në shërbimin shëndetësor, arsim e shkencë, si dhe për angazhimin e vazhdueshëm shoqëror për edukimin e brezave.
2. Dekorata për humanizëm “Dr. Ali Sokoli” i jepet të lartpërmendurit më datë 12 gusht 2025.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit, me Nr. Prot. 01 Nr. 327/22 të datës 31.5.2022, dekorata për humanizëm “Dr. Ali Sokoli” u jepet personave që merren me aktivitete humanitare apo atyre që me punën dhe me përkushtimin e tyre humanist kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të jetës e të punës për njerëzit në nevojë.

Pas kësaj, kryetari i Komunës, me vendimin Nr. 02/6392 të datës 6.8.2025, caktoi komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”. Komisioni, pas mbledhjes së mbajtur dhe shqyrtimit të propozimeve për dhënien e dekoratës për humanizëm, i rekomandoi kryetarit të Komunës që dekorata për humanizëm “Dr. Ali Sokoli”, t’i jepet Prof. dr. Samedin Haxhijaha, pas vdekjes, për kontributin shumëvjeçar të dhënë në shërbimin shëndetësor, arsim e shkencë, si dhe për angazhimin shoqëror për edukimin e brezave. Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- Familjarët e Prof. dr. Samedin Haxhijaha,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6409 Nr. i faq./Br.str./No.pg 143

Data/Datum/Date 13 / 8 / 2025

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 21 paragrafi 1, paragrafi 2 dhe paragrafi 4, nenit 33 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 44 paragrafi 4 pika 4.1 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) NR. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, rekomandimit të Komisionit Komunal për Riintegrim, i themeluar me vendimin 02/271 të datës 14.7.2014, kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për pagesën e qirasë për akomodim për të riatdhesuar

1. **MIRATOHET** kërkesa me nr. prot 2407, e datës 21.7.2025 e [REDACTED] nga Rahoveci, i riatdhesuari nga Gjermania, më datë 17.6.2024, për pagesën e qirasë për akomodim në shumën prej 280€ (dyqind e tetëdhjetë euro) në muaj për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit.
2. Pagesa e qirasë sipas pikës 1 të këtij vendimi do të paguhet për 6 (gjashtë) muaj, duke filluar nga data 1.8.2025 deri më datë 31.1.2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më datë 24.7.2025, ka shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 2407 të datës 21.7.2025 e parashtruar nga i ri-atdhesuar [REDACTED] nga Rahoveci, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit, për akomodim me qira, duke u bazuar në rekomandimet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

I lartpërmenduri po përballat me një situatë të rëndë socio-ekonomike dhe është në kërkim të strehimit të përkohshëm [REDACTED] pavarësisht se është nga Rahoveci, ka kërkuar strehim në Gjakovë për shkak të një situate të ndërlikuar familjare. Para luftës, familjarët e tij u larguan nga Rahoveci për shkak të një ndërlikimi në gjakmarrje dhe ai ende ka frikë nga pasojat e mundshme në rast të kthimit dhe se situata e tij kërkon një zgjidhje të përhershme për strehim në Gjakovë.

Kërkesa për akomodim me qira i aprovohet për periudhën 6 (gjashtë) mujore, duke filluar nga data 1.8.2025 deri më datë 31.1.2026 në shumën prej 280€ (dyqind e tetëdhjetë euro) në muaj, për të vazhduar procesin e trajtimit të statusit të tij më tutje për mbështetje nga niveli komunal, sipas dispozitave të Rregullores (QRK) NR. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara dhe sipas dëshmive të paraqitura, konstaton se i riatdhesuari i plotëson kriteret për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit, për akomodim

me qira, të përcaktuar me Rregulloren QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e personave të riatdhesuar, respektivisht nenit 21, paragrafi 1, paragrafi 2 dhe paragrafi 4, nenit 33 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 44 paragrafi 4 pika 4.1 dhe paragrafi 5.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të tij në Komisionin për Ankesa në DRPR, përmes Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR] nga Rahoveci,
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim,
- Koordinatori Rajonal i MPB-së, dhe
- Arkivi.

Smail Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT / KANCELARIJA I PRESIDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S OFFICE

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 6410 Nr. ifaq/Erstr/No.pg 143
Data/Datumi/Date 18 / 3 / 2025
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 6/170 të datës 13.8.2025 për ndërprerjen e kontratës me titull: "Furnizimi me oksigjen dhe boca të oksigjenit" me nr. të prokurimit 623-25-942-1-3-6/C661, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull "Furnizimi me oksigjen dhe boca të oksigjenit"

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull "Furnizimi me oksigjen dhe boca të oksigjenit" me nr. të prokurimit 623-25-942-1-3-6/C661.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanshme sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të mospërmbushjes së obligimeve të kontratës, respektivisht mosfurnizimin me artikujt e përshkruar në kontratë.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim autoriteti kontraktues), ka nënshkruar kontratë publike kornizë me operatorin ekonomik "Vitech" Sh.p.k. me seli në Prishtinë (në vazhdim kontraktuesi), me titull "Furnizimi me oksigjen dhe boca të oksigjenit" me nr. të prokurimit 623-25-942-1-3-6/C661 me nr. prot. 1363 të datës 23.4.2025.

Pas nënshkrimit të kontratës, edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme nga menaxheri i kontratës për furnizim me artikuj, të cilat janë objekt i kësaj kontrate, kontraktuesi nuk e ka furnizuar autoritetin kontraktues me asnjë produkt, me arsyetimin se furnizimi me oksigjen të gaztë (që është objekti i kontratës) është i vështirë pasi ky lloj produkti është i monopolizuar në treg nga një kompani e vetme dhe se e njëjta është duke refuzuar shitjen e tij te furnitorët e tjerë.

Gjithashtu, përmes këtij emaili, kontraktuesi - operatori ekonomik "Vitech" Sh.p.k. ka rekomanduar dhe njëkohësisht ka kërkuar nga menaxheri i kontratës që të bëjë ndërprerjen e kësaj kontrate me marrëveshje të dyanshme, pasi furnizimi me oksigjen të gaztë është i pamundur për arsyet e lartcekura.

Provë: emaili i kompanisë "Vitech" Sh.p.k. i datës 13 qershor 2025.

Pas kësaj kërkesë të kontraktuesit, menaxheri i kontratës, më datë 13.8.2025, i është drejtuar kryetarit të Komunës me kërkesë/rekomandim për ndërprerjen e kontratës me titull "Furnizimi me oksigjen dhe boca të oksigjenit" me nr. të prokurimit 623-25-942-1-3-6/C661, me nr. prot. 1363 të datës 23.4.2025, sipas kërkesës së arsyetuar të operatorit ekonomik.

Pas administrimit të të gjitha provave, kryetari i Komunës ka konstatuar që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me titull "Furnizimi me oksigjen dhe boca të oksigjenit" me nr. të prokurimit 623-25-942-1-3-6/C661, me nr. prot. 1363, të datës 23.4.2025, me marrëveshje të dyanshme.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 10 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në autoritetin kontraktues.

Me vendim të njoftohen:

- Zyra e Prokurimit,
- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe
- Arkivi.


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës